



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate



COVID-19

dhe sipërmarrja
në Shqipëri

ANALIZË KRAHASUESE
2020-2021

COVID-19 DHE SIPËRMARRJA NË SHQIPËRI

ANALIZË KRAHASUESE 2020-2021

PËRMBAJTJA

GJETJE KRYESORE	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA	6
ANALIZA E TË DHËNAVE	7
KAMPIONI	7
ANALIZA KRAHASUESE E REZULTATEVE TË ANKETIMEVE	9
NDËRPRERJA E AKTIVITETIT GJATË PANDEMISË	9
NDIKIMI I COVID19 NË AKTIVITETIN E BIZNESEVE	11
NDIKIMI I COVID19 NË TË ARDHURAT (XHIRON VJETORE) TË BIZNESIT	13
IMPORTET GJATË COVID19	15
SFIDAT E COVID19	18
COVID19 DHE SHËRBIMET ONLINE	21
PËRBALLIMI I EMERGJENCAVE	22



Këshilli i Investimeve është një platformë dialogu publik-privat dhe ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Këshilli i Investimeve kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues të qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve për zhvillim. Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO).

GJETJE KRYESORE

Pandemia COVID19, situatë e pa-precedentë gjatë viteve 2020-2021, perceptohet se ndaloj aktivitetin e më shumë se gjysmës së kompanive në të gjithë sektorët e ekonomisë shqiptare, kryesisht si rezultat i masave të parandalimit të përhapjes së pandemisë si edhe vështirësive të krijuara në tregtinë e mallrave dhe shërbimeve. Gjithsesi, lehtësimi i masave kufizuese dalëngalë e ri-ktheu ekonominë në aktivitetin normal, ku vetëm 15% e bizneseve deklaruan se edhe një vit pas fillimit të pandemisë nuk e rifilluan aktivitetin e tyre, kryesisht në sektorin e turizmit.

Një vit pas fillimit të pandemisë, kompanitë ulën pritshmëritë e tyre “shumë negative” ndaj pandemisë në aktivitetin e tyre ekonomik. Një pjesë e bizneseve që në vitin 2020 mendonin se pandemia do të kishte një impakt “shumë negativ” në biznesin e tyre, në 2021 e kanë vlerësuar tashmë këtë impakt në shumicë si “negativ”, ndërkohë që vihet re një rritje e numrit të bizneseve që mendojnë se pandemia nuk do të ketë ndonjë ndikim në aktivitetin e tyre, si dhe të atyre që mendojnë se impakti ka qenë, në fakt, pozitiv kryesisht në Sektorin e Shërbimeve.

Shumica dërrmuese e bizneseve në të gjithë sektorët e ekonomisë raportuan ulje të të ardhurave të tyre në më shumë se 20%, përgjatë periudhës së pandemisë, si në fillimet e saj, ashtu edhe përgjatë vitit të parë të COVID19. Në ndryshim nga anketa e vitit 2020 ku pothuajse të gjitha bizneset e të gjithë sektorëve deklaruan rënie të të ardhurave, në anketën e vitit 2021 vihet re se një përqindje modeste e bizneseve në sektorin e shërbimeve, ndërtimit dhe të tregtisë (përkatesisht 2,2%, 5,9% dhe

2,5%) raportojnë rritje të të ardhurave me më shumë se 5%.

Nga të dhënat e raportuara, duket se viti i pandemisë i ka detyruar bizneset që të ulin varësinë e tyre ndaj importeve dhe të përpiqen t’i zëvendësojnë ato me produkte vendase. Shërbimet, Bujqësia dhe Ndërtimi janë sektorët që më së shumti kanë mundur të gjejnë mbështetje edhe tek produktet vendase.

Për të dyja periudhat e marra në analizë, dy nga problemet kryesore për bizneset e të gjithë sektorëve mbeten mungesa e klientëve dhe e likuiditetit. Mungesa e klientëve është raportuar si një problem në rritje veçanërisht nga sektori i turizmit dhe ai i shërbimeve. Ndërsa, nga sektori i ndërtimit dhe ai i tregtisë, vihet re një rritje në raportimin e problematikës të mungesës së likuiditetit si një ndër shqetësimet kryesore.

Përdorimi i teknologjisë dhe shërbimeve elektronike duket se morën hov gjatë pandemisë dhe u përdorën në masë nga kompanitë. 87% e bizneseve në 2021, krahasuar me 81% të anketës së 2020, raportuan se do të vazhdojnë të mbështeten tek këto shërbime edhe në të ardhmen.

Pandemia e COVID19 nxori më në pah pa-përgatitjen e kompanive në përballimin e situatave emergjente. Kur u pyetën në vitin 2020 nëse kishin të miratuar ndonjë plan për situatat emergjente, plot 86% e bizneseve u përgjigjën negativisht, duke shprehur se nuk e kishin menduar asnjëherë miratimin e një plani të tillë. Një vit pas pandemisë, mbi 50% e bizneseve përgjigjen se po konsiderojnë miratimin e një plan-strategjie për t’u përballur me situatat emergjente, sidomos në sektorin e Bujqësisë, Tregtisë dhe Turizmi.

HYRJJE

Në përmbushje të qëllimit të tij për vlerësimin e klimës së përgjithshme të të bërit biznesit në Shqipëri, Sekretariati Teknik i Këshillit të Investimeve ndërmori iniciativën për të organizuar dy anketime gjatë periudhës së pandemisë në vend, me një distancë kohore prej një viti nga njëra-tjetra.

Qëllimi i kësaj analize është të krahasojë diferencat në përgjigjet e bizneseve në harkun kohor të një viti, si edhe të evidentojë të përbashkëtat dhe gjetjet kryesore nga vlerësimet e bizneseve mbi impaktin që pandemia ka pasur në aktivitetin e tyre.

Ky publikim u realizua në bashkëpunim me studentin Tomas Muça, student i Universitetit EPOKA

METODOLOGJIA

Anketa e parë u ndërmor në periudhën prill-maj 2020, ndërsa anketa e dytë gjatë periudhës prill-maj 2021. Të dyja anketat përmbanin pyetje të hapura dhe të mbyllura, kryesisht për të mbledhur informacion në lidhje me

(i) **Ndikimi i COVID19 në aktivitetin e biznesit;**

(ii) **COVID19 dhe importet;**

(iii) **Sfidat e COVID19;**

(iv) **COVID19 dhe shërbimet online.**

Anketat u shpërndanë bizneseve kryesisht nëpërmjet postës elektronike. Të gjitha përgjigjet u mbledhën online, me plot 833 biznese që iu përgjigjën anketës gjatë periudhës së fillimit të pandemisë dhe 427 të tilla që iu përgjigjën anketës një vit më pas. Për analizën e të dhënave u përdor metoda e thjeshtë rastësore¹.

¹ Për më shumë informacion në lidhje me metodologjinë dhe analizën, klikoni publikimet tona [Anketa 2020 "Covid19 dhe biznesi"](#); [Anketa 2021 "Covid19 dhe biznesi"](#)

ANALIZA E TË DHËNAVE

KAMPIONI

Figura 1. Shpërndarja gjeografike e të anketuarve




Figura 2. Madhësia e biznesit bazuar në xhiron e fundit





Figura 3. Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit




ANALIZA KRAHASUESE E REZULTATEVE TË ANKETIMEVE

NDËRPRERJA E AKTIVITETIT GJATË PANDEMISË

Përgjigjet e bizneseve tregojnë një diferencë të madhe mes bizneseve që e mbyllën totalisht aktivitetin e tyre gjatë periudhës fillestare të pandemisë, me ato që vazhduan ta mbajnë biznesin e mbyllur edhe pas një viti nga fillimi i pandemisë. Shkaku i kësaj difference prej 32 pikë përqindjeje është rrjedhojë direkte e detyrimit të mbylljes së

bizneseve nga izolimi i vendosur në fillimet e pandemisë, periudhë kjo e cila përkon me atë kur është zhvilluar anketimi i parë i vitit 2020. Këto të dhëna tregojnë se një pjesë e mirë e bizneseve që u detyruan ta mbyllin aktivitetin e tyre në fillimet e pandemisë, patën mundësi të rifillonin normalisht me punën e tyre deri në një vit pas fillimit të saj.

Figura 4. Mbyllja e aktivitetit ekonomik si pasojë e COVID19



Dy grafikët e mëposhtëm tregojnë një reduktim të dukshëm të ndërprerjes totale të aktivitetit për të gjithë sektorët, duke krahasuar të dhënat e anketës të vitit 2020 me ato të vitit 2021. Kjo është shoqëruar me rritjen e numrit të bizneseve që raportojnë ndërprerje të pjesshme të aktivitetit të tyre. Një diferencë shumë e konsiderueshme është

ajo në sektorin e turizmit, me një rënie nga 75,3% të bizneseve të këtij sektori që raportonin ndërprerje totale të aktivitetit në vitin 2020, në vetëm 31% që raportojnë të njëjtën gjë në vitin 2021. Kjo mund të ketë ardhur si rrjedhojë e hapjes së Shqipërisë përgjatë sezonit turistik në verë, si për turistët vendas, ashtu edhe për ata të huaj.

Gjithashtu, vihet re një rritje domethënëse e numrit të bizneseve në sektorin e shërbimeve që deklarojnë se nuk e kanë ndërprerë aktivitetin e tyre në asnjë moment, nga 13% në 31%, si dhe një rënie e numrit të bizneseve në sektorin e bujqësisë që raportojnë

se aktiviteti i tyre nuk u ndërpre në asnjë moment, nga 24% në 10%. Një ndër faktorët që mund të ketë ndikuar në këtë diferencë është vështirësia në eksportet e këtyre bizneseve për shkak të kufizimeve apo edhe mbylljes së kufijve.

Figura 5. Mbyllja e aktivitetit si pasojë e COVID19 sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

NDIKIMI I COVID19 NË AKTIVITETIN E BIZNESEVE

Në përgjithësi në 2021, u vu re një tendencë rënëse e *këndvështrimit negativ* që bizneset patën mbi ndikimin e pandemisë në aktivitetin e tyre. Nga krahasimi i të dhënave, vihet re se nga 67% e bizneseve që e vlerësonin impaktin e COVID19 si “shumë negativ” në 2020, kjo shifër zbriti në 43% në vitin 2021. Një pjesë e bizneseve që në vitin 2020 men-

donin se pandemia do të kishte një impakt “shumë negativ” në biznesin e tyre, e kanë vlerësuar tashmë këtë impakt në shumicë si “negativ”, ndërkohë që vihet re një rritje e numrit të bizneseve që mendojnë se pandemia nuk do të ketë ndonjë ndikim në aktivitetin e tyre, si dhe të atyre që mendojnë se impakti ka qenë, në fakt, pozitiv.

Figura 6. Si e vlerësoni ndikimin e COVID19 në aktivitetin tuaj?



Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Sikundër vihet re nga grafiku i mëposhtëm, edhe në të dhënat e segmentuara sipas llojit të aktivitetit të bizneseve, ka një rritje të ndjeshme të të anketuarve që impaktin e pandemisë COVID19 në biznesin e tyre e konsiderojnë tashmë si “negativ” dhe jo “shumë negativ”. Sektori që dallon më tepër për këtë përmirësim të përshtypjes mbi impaktin e COVID19 është ai i industrisë, me një

rënie prej 31 pikë përqindjeje të bizneseve të industrisë që e kanë vlerësuar impaktin e pandemisë si “shumë negativ” (nga 65% në vitin 2020, në 34% në vitin 2021). Nga ana tjetër, pavarësisht kësaj rënieje, sektori i turizmit mbetet më i ndikuar negativisht nga pandemia, me 71% të bizneseve që vazhdojnë t’a konsiderojnë impaktin si “shumë negativ”, nga 81% që ishin në vitin 2020.


Figura 7. Ndikimi i COVID19 në aktivitet sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë



Në mënyrë të ngjashme, edhe në segmentimin e të dhënave sipas xhiros vjetore të bizneseve, vihet re një përmirësim i perceptimit mbi ndikimin e pandemisë në aktivitetin e bizneseve të anketuara pas vitit të parë të fillimit të pandemisë. Përqindja e bizneseve që zgjedhën alternativën “shumë negativ” për t’iu përgjigjur pyetjes mbi impaktin e COVID19 ra për të gjitha kategoritë e xhiros vjetore, ku ajo që dallon më shumë është përgjysmimi

në terma relativ i bizneseve të mëdha (mbi 14 milionë ALL) që përzgjedhën këtë alternativë, nga 65% në 32%. Gjithashtu, vihet re një rritje e lehtë e numrit të bizneseve që përzgjedhën alternativën “pa ndikim”, si dhe të atyre që u përgjigjën se pandemia kishte pasur ndikim pozitiv në aktivitetin e tyre. Kjo u vu re më shumë te bizneset në kategorinë e xhiros deri në 5 milion ALL dhe të atyre me 5 deri në 8 milion ALL.

Figura 8. Ndikimi i COVID19 në aktivitet sipas madhësisë së kompanisë





Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

NDIKIMI I COVID19 NË TË ARDHURAT *(xhiron vjetore)* TË BIZNESIT

Shumica dërrmuese e bizneseve në të gjithë sektorët e ekonomisë raportojnë ulje të të ardhurave të tyre përgjatë periudhës së pandemisë, si në fillimet e saj, ashtu edhe përgjatë vitit të parë të COVID19. Në anketën e vitit 2021, vihet re një rritje e lehtë e bizneseve që deklarojnë se pandemia nuk ka pasur ndikim në të ardhurat e tyre vjetore.

Në ndryshim nga anketa e vitit 2020 ku pothuajse të gjitha bizneset e të gjithë sektorëve deklaruan rënie të të ardhurave, në anketën e vitit 2021 vihet re se një përqindje modeste e bizneseve në sektorin e shërbimeve, ndërtimit dhe të tregtisë (përkatesisht 2,2%, 5,9% dhe 2,5%) raportojnë rritje të të ardhurave me më shumë se 5%.

Figura 9. Ndikimi i COVID19 në të ardhurat sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë





Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Për të gjitha kategoritë e bizneseve sipas të ardhurave vjetore, vihet re një ulje e konsiderueshme e numrit të bizneseve që raportojnë rënie të të ardhurave të tyre me më shumë se 20%. Kjo shifër ka rënë nga 80,7% në 71,2% për bizneset me xhiro deri në 5 milion lekë, nga 83,8% në 71% për ato me xhiro nga 5 deri në 8 milion lekë, nga 82,4% në 76,4% për bizneset me xhiro nga 8 deri në 14 milion lekë, si dhe një rënie shumë e konsiderueshme nga 78,3%

në 48% për bizneset e mëdha me xhiro mbi 14 milion lekë. Kjo tregon se *bizneset e mëdha e përballuan më mirë krizën e pandemisë, duke ruajtur nivele më modeste të rënies së të ardhurave të tyre*. Nga ana tjetër, mbi 10% e bizneseve të mëdha deklarojnë në anketën e vitit 2021 se pandemia nuk pati asnjë ndikim negativ në të ardhurat e tyre, ndërsa 3,3% deklarojnë se patën madje edhe një rritje prej më shumë se 5% të të ardhurave të tyre vjetore.

Figura 10. Ndikimi i COVID19 në të ardhura sipas madhësisë së biznesit




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

IMPORTET GJATË COVID19

Bizneset raportojnë se gjatë vitit të parë të pandemisë, kanë hasur më shumë problematika në furnizimin me mallra dhe lëndë të para nga importi, me 69% të bizneseve duke konfirmuar këtë krahasuar me 52% në fillimet e pandemisë.

Figura 11. Problematikat në furnizimin me mallra dhe lëndë të parë nga importi




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Nga të dhënat e grafikut të mëposhtëm, duket se viti i pandemisë i ka detyruar bizneset që të ulin varësinë e tyre ndaj importeve dhe të përpiqen t'i zëvendësojnë


ato me produkte vendase. Shërbimet, Bujqësia dhe Ndërtimi janë sektorët që më së shumti mund të gjejnë mbështetje edhe tek produktet vendase.

Figura 12. Varësia nga importet



Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Nëse po, a ndikuan këto mungesa në vijimësinë e veprimtarisë suaj në biznes (Anketa 2021):




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Bizneset raportuan në vitin 2020 për *problematika në lidhje me importet* nga një sërë vendesh, ku atë kryesorin e zinin shtetet anëtare të BE-së dhe Kina. Si rrjedhojë, një


pjesë e mirë e bizneseve, sipas përgjigjeve të anketës 2021, ndryshuan vendet importuese, *ndërsa plot 21% e tyre zëvendësuan importet në masën 100% me produkte vendase.*

Figura 13. Problematikat me importet dhe ndryshimi i vendeve importuese



Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Figura 14. Ndryshimi i vendeve importuese




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

SFIDAT E COVID19


Për të dyja periudhat e marra në analizë, dy nga problemet kryesore për bizneset e të gjithë sektorëve mbetën *mungesa e klientëve dhe e likuiditetit*. Mungesa e klientëve është raportuar si një problem në rritje veçanërisht nga sektori i turizmit dhe ai i shërbimeve. Ndërsa, nga sektori i ndërtimit dhe ai i tregtisë, vihet re një rritje në raportimin e problematikës të mungesës së likuiditetit si një ndër shqetësimet kryesore. Nga ana tjetër, pamundësia për të paguar pagat raportohet si një ndër 3

problemet kryesore për bizneset e sektorit të turizmit dhe të tregtisë për vitin 2020, por nuk renditet më ndër 3 problemet kryesore për asnjë sektor në vitin 2021. Kjo kryesisht vjen si rrjedhojë e politikave suportuese të lançuara nga qeveria në mbështetje të biznesit vendas në kushtet e pandemisë. Edhe bujqësia dhe ndërtimi, që identifikonin organizimin e punës si një ndër problemet e tyre kryesore, nuk e evidentojnë më këtë shqetësim një vit pas fillimit të pandemisë.

Figura 15. Problemet kryesore me të cilat po hasen bizneset



Cilat janë tre problemet më kryesore me të cilat po ndeshet aktualisht kompania juaj? (Anketa 2020)




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Vihet re një tendencë e bizneseve në shfrytëzimin e mundësisë së punës online nga shtëpia, për të adresuar sfidën e mungesës së fuqisë punëtore. 52% e bizneseve të cilat


shfrytëzuan punën online gjatë vitit të parë të pandemisë, deklarojnë se do ta shfrytëzojnë këtë mundësi edhe në të ardhmen si alternativë ndaj punës në zyrë.

Figura 16. Fuqia punëtore



Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Në të ardhmen, a do të merrni në konsideratë punën online, si një alternativë ndaj punës në zyrë?




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Krahasimi i të dhënave tregon se ka një reduktim të planeve të bizneseve për të larguar punonjës nga puna apo për të ulur prodhimin e tyre për të siguruar vazhdimësinë e biznesit. Duket se këto zgjidhje të përkohshme, të cilat ishin më të zakonshme në periudhën

fillestare të pandemisë, po tejkalohen. Nga ana tjetër, një pjesë më e madhe e biznesve mund të mbështeten në kredi bankare apo në të ardhurat e periudhave të mëparshme për të adresuar sfidat që lidhen me vazhdimësinë e biznesit të tyre.

Figura 17. Masat për të adresuar vazhdimësinë e biznesit

Cilat janë masat që do të ndërmerrni për të siguruar vazhdimësinë e biznesit tuaj?



Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI


COVID-19 DHE KONSOLIDIMI I SHËRBIMEVE ONLINE

Një pjesë më e madhe e bizneseve raporton se ka përdorur shërbimet elektronike gjatë pandemisë, duke shënuar një rritje prej 9 pikë përqind-

jeje, nga 75% e bizneseve që përgjigjeshin "Po" në anketën e vitit 2020, në 84% që përgjigjen në të njëjtën mënyrë në anketën e vitit 2021.

Figura 18. Shërbimet elektronike

A i keni përdorur shërbimet elektronike në këtë periudhë?




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

Në mënyrë të ngjashme, 87% e bizneseve krahasuar me 81% të anketës së mëparshme, raportojnë se po konsiderojnë që të vazhdojnë t'i përdorin këto shërbime edhe në të ardhmen.

Figura 19. Shërbimet elektronike

A mendoni se do t'i përdorni edhe në të ardhmen?




Burimi: Anketat e Sekretariatit të KI

PËRBALLIMI I EMERGJENCAVE

Pandemia e COVID19 vuri në vështirësi një pjesë të madhe të bizneseve në Shqipëri. Kur u pyetën në vitin 2020 nëse kishin të miratuar ndonjë plan për situatat emergjente, plot 86% e bizneseve u përgjigjën negativisht, duke

shprehur se nuk e kishin menduar asnjëherë miratimin e një plani të tillë. Një vit pas pandemisë, mbi 50% e bizneseve përgjigjen se po konsiderojnë miratimin e një plan-strategjie për t'u përballur me situatat emergjente.

Figura 20. Plan për situatat emergjente



RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)
Drejtoresh e Sekretariatit
lekaad@investment.com.al


Elvis Zerva
Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara
Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha
Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula
Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).

www.investment.com.al



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

COVID-19

dhe sipërmarrja
në Shqipëri